



## **Programi për nder të 28 Nëntorit**

Festa e 28 Nëntorit nisi me valle. Si lule të bukura në pranverë, edhe pse shumë të vogla, e ndjenë se si rrahë zemra për Morenë tonë të lënë jashtë trojeve shqiptare. Vajzat e klasës së parë, të dytë dhe të tretë dolën në skenë me vallëzimin e quajtur sipas këngës "Moj e Bukura More."



Në shkollën tonë ka edhe mjaft djem të talentuar. Pikat e radhës na dëshmuuan këtë. Shend Sulejmani luajti në piano, ndërsa Rron Aliu në kitarë, që të dy në klasë në pestë.

Për të shprehur emocione të thella, për përpjekjet e popullit tonë për liri, drejtësi e pavarësi me recitalin e përgatitur "Poemi kosovar" të Mitrush Kutelit, Mjellma, Rilindi, Albesi, Morea, Ilirida dhe Donika pasqyruan më së miri gjithë rrugën e vuajtjes, sakrificës dhe vrullit për liri e paqe.

## **Redaksia**

### **Kryeredaktore**

Zana Buçinca

### **Redaktore**

Buena Aziri

### **Anëtarë të redaksisë**

Dina Spahiu

Arian Dobërçani

Donika Kryeziu

Plarenta Dëshishku

Vesa Reçica

Vesa Hoxha

Abetare Kabashi

Dion Krapi

Diona Halili

Luneta Sahiti

Jon Latifi

Artmir Azizi

Pas pikës kryesore të programit, recitalit, në skenë dolën fjollat tona, që dinë të bëhen edhe pata, edhe lule, edhe zogj, sepse ato janë si vesa e mëngjesit. "Vallëzimin e patave" e sollën nxënëset e klasës së parë dhe të dytë.

Në çdo manifestim tonin, zëri i saj po na shoqëron, pasi me të zbuluar talentin e saj, Dua është pjesë e pandashme e tyre.

Lulet me nektarin e tyre të çiltër ushqejnë të tjerët. Mbushin ambientin tonë me bukuri e gjallëri. Balerinat simpatike, Rina, Gresa dhe Dita si mjellma të bukura na mbushën zemrat tona. Ato dolën në skenë me "Liqeni i mjellmave".

Një akt të komedisë "14 vjeç dhëndër' në të cilin flitet për dy gra, të cilat kanë shkuar në mulli për të bluar grurin dhe njëra ia zë rendin tjetrës, kështu që plas një zënkë mes tyre...po kush do t'i ndajë të mos rrihen. Këtë e shfaqën për mrekulli në skenë, tre nxënës të mrekullueshëm, Donika, Fiona dhe Albani.

Zëri i talentes tjetër të muzikës Mjellma Istrefi ishte pjesë e këtij programi të larmishëm.

Vallëzimin modern në shkollën tonë e sollën disa vajza moderne, që e kanë pasion vallëzimin. Fiona, Morea dhe Zana, nën shoqërinë e Diellza Dobroshit, me këngë kënaqen dhe falënderuan arsimtarët që u qëndruan afër për të përgatitur këtë program artistik, arsimtarët e gjuhës, Violetë Pllana dhe Fatmir Fezriu, arsimtaren e muzikës Yllnora Limani, dy mësueset Lirika Bërdynaj dhe Kaltrina Kabashi për punën për dy vallëzimet me fëmijë të vegjël. Pjesë e këtij manifestimi ishte edhe ekspozita e hapur në ambientet e shkollës, e përgatitur nga nxënësit, me ndihmën e arsimtares së Artit Figurativ, Mirlinda Ramadani, enkas për nder të 28 Nëntorit.



## Klubet në ciklin e ultë

Nxënësit e vegjël që germëzojnë dhe shqiptojnë shkronjat e bukura të gjuhës shqipe nuk ndalen me kaq. Ata duan të jenë pjesë e klubeve që funksionojnë në shkollën tonë. Funksionimi i klubeve ka filluar punën me datën 15. X. 2009 dhe do të vazhdojë gjatë gjithë vitit shkollor. Në këto klube përfshihen gjithë nxënësit nga klasa e I-rë deri në të III-ën.

Gjithsej funksionojnë shtatë grupe të klubeve: *Klubi i Recituesve, Krijuesve të rinj*; artistët e vegjël në *Klubin e Dramës*; folësit e vegjël në *Klubin e Gjuhës angleze*; piktorët e vegjël me duart e tyre të arta në *Klubin e Artit*; të shkathtit në *Klubin Punëdore*; valltarët e vegjël në *Klubin e Vallëzimit*; dhe sportdashësit në *Klubin e Sportit*.

Këto klube kanë për qëllim zhvillimin e aftësimit të fëmijëve në lëmi të ndryshme dhe ndër to: Të shprehen lirshëm përmes krijimeve të tyre, të aktrojnë role të ndryshme përmes shfaqjeve, të shprehen lirshëm në Gjuhën angleze, të shprehen përmes artit, punëdore dhe vallëzimit, të aftësohen në sporte të ndryshme.

Deri tash klubet kanë funksionuar mjaft mirë, fëmijët janë shumë të kënaqur dhe në fund të këtij gjysëmvetori e tërë puna e klubeve u finalizua dhe u prezantua në programin festiv për nder të 28 Nëntorit.

## Java e projekteve

Si çdo vit, edhe këtë herë, në shkollën tonë u mbajt Java e Projekteve, në të cilën të gjithë nxënësit patën mundësinë që të tregojnë aftësitë e tyre në lëndët e përzgjedhura. Projektet janë ndarë në dy grupe nxënësish. Grupin e parë e përbënin klasat e 6-ta, 7-ta dhe të 8-ta, ndërsa grupin e dytë e përbënin klasat e 9-ta dhe të 10-ta.

Të gjitha projektet kishin diçka të veçantë. Një ndër projektet e veçanta ishte ai i klasave të 9-ta dhe 10-ta, që kishte të bënte me Zgjedhjet – temë aktuale kjo për Kosovën. Në këtë projekt nxënësit mësuan gjithë procedurën e nevojshme, se si bëhen zgjedhjet. Këtë e mundësoi edhe vizita dhe ndihmesa që dhanë disa nga përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilët nuk hezituan të ndihmonin nxënësit me mjetet e nevojshme dhe këshillat e duhura. Nxënësit, improvizuan edhe votimin, të ndihmuar nga arsimtari i Edukatës Qytetare Sead Jakupi dhe ai i Gjuhës shqipe Agron Gashi.

Projekt tjetër që gjithashtu kishte të bënte me zgjedhjet ishte projekti: *Gabimet gjuhësore në fushatën zgjedhore*. Nxënësit, përçollën gjatë gjithë javës së projekteve fushatën zgjedhore duke u ndalë konkretisht në gabimet e përfaqësuesve politikë, të cilët jo vetëm që bënin gabime në të folur, por gabimet ishin të shumta në të shkruar dhe të prezantuara edhe në reklamat e mëdha (Bilbordet). Detyra e nxënësve ishte që të korrigjonin këto gabime dhe të shkruanin e prezantonin formën e drejtë të tyre.

Makinat llogaritëse ishte një projekt që kishte për qëllim, që nxënësit të kuptonin dobhtë që sjellin makinat llogaritëse, por edhe të metat.

Nxënës të tjerë që pëlqyen projektin *Trupat Gjeometrikë* u përfshinë në këtë projekt dhe mësuan më shumë e sollën informacione të reja për rëndësinë e trupave gjeometrikë.



Ata që donin të argëtoheshin më shumë dhe të mësonin më tepër për *Artin e Vallëzimit* morën pjesë në këtë projekt dhe kurorëzuan me sukses përpjekjet duke nxjerrë në fund të javës disa pika vallëzimi.

Arkimedi, kur kuptoi rezultatin e studimit të tij tha Eureka. Fizikanët e vegjël, rrugën e duhur për të ardhur deri të njohuritë e reja në Fizikë, u përpoqën ta zbulojnë pikërisht në projektin e Fizikës *Eureka*, në të cilin nxënësit zhvilluan punë eksperimentale.

Ata që kanë në qejf më shumë rrushin dhe duan të dinë më shumë se si rritet e prodhohen produktet e tij ishin pjesë e projektit *Hardhia e Rrushit*. Ditën e parë të projektit, para nxënësve gjithë procesin e rritjes së hardhisë së rrushit e prezantoi eksperti për kultivimin e hardhisë së rrushit, prof. dr. Bashkim Korenica.

Për të ruajtur të vërtetën njerëzore dhe të kaluarën historike të një populli, burimet historike janë më se të nevojshme. Arkivat shtetërore janë ato që ruajnë këto burime. Disa nxënës vizituan Arkivin Historik të shtetit të Kosovës dhe mësuan se si ruhen këto burime dhe se sa të rëndësishme janë ato. Të gjithë këtë përvojë ata u përpoqën ta paraqesin përmes prezantimeve të tyre në ditën e prezantimit bashkë me projektet e tjera.

Mësimdhënësit si çdoherë u ndanë të kënaqur me punën e palodhur të nxënësve.

## **Ekspozita e punimeve të nxënësve**

Pjesë e projekteve ishin edhe cikli i ultë duke filluar që nga klasa e parë. Ata mësuan për të parët tanë, Ilirët. Të gjitha punimet e nxënësve, në javën e projekteve u prezantuan në ekspozitën e hapur në Hapësirën për shumë qëllime, në ambientet e shkollës.

Ekspozita ishte e hapur gjatë gjithë javës dhe prindërit ishin të ftuar, që të shihnin punën e fëmijëve të tyre. Ata që kishin kohë dhe mundësi vizituan me shume dëshirë, këtë ekspozitë dhe mbeten të kënaqur nga punimet e fëmijëve të tyre, duke i shkruar edhe disa fjalë në librin e përshtypjeve.



## **Turneu '09**

Edhe këtë vit, gjatë javës së projekteve, u mbajt turneu i futbollit dhe basketbollit ku morën pjesë nxënësit e klasave V-X. Në turneun e futbollit luanin djemtë, kurse në atë të basketbollit luanin vajzat.

Fillimisht luajtën klasat e pesta, të gjashta, e kështu me radhë. Finalet u luajtën mes fituesve të klasave të pesta dhe të gjashta, të shtata dhe të teta, si dhe të nënta dhe të dhjeta.

Turneu përfaqësoi momente çlodhëse nga procesi i përditshëm mësimor në javën e projekteve. Ishte një turne shumë emocionues, sidomos në ditën e finales, në futboll mes klasave IX/2 dhe X/2. Në atë finale u dhanë shumë gola dhe së fundi me pak fat fitoi dhe festoi klasa X/2, ndërsa prej vajzave dolën fituese dhe morën kupën klasa X/2.

Turneu ishte mjaft mirë i organizuar, pasi që për këtë u përkujdesën arsimtarët e palodhur të Edukatës Fizike, Driton Mamaj dhe Edona Cami. Turneu përfundoi me shpërndarjen e kupave, për klasat fituese, nga drejtoresha Afrore Lila. Duartrokitjet e brohoritjet e nxënësve të tjerë nuk munguan për fituesit, ato ishin të shumta.



## Vizitë stacionit meteorologjik

Që të mësonin diçka më shumë rreth parashikimit të motit, matjes së temperaturës, shtypjes atmosferike dhe gjithçka tjetër rreth motit, më 19.11.2009 nxënësit e klasave të dhjeta të shkollës sonë vizituan stacionin meteorologjik në Prishtinë. Atje, i priti vetë drejtori i këtij stacioni, i cili ua shpjegoi punën e secilës prej pajisjeve matëse bashkëkohore që ka në dispozicion stacioni. Përveç, që panë se si funksiononin pajisjet, nxënësit hynë edhe në laboratorin e analizave të ujit dhe të dheut, që gjendet në këtë stacion meteorologjik. Laboratori ishte i pajisur me pajisje moderne, me të cilat zhvilloheshin analiza dhe mbaheshin statistika të ndryshme. Kjo vizitë u bë jashtë planprogramit të lëndëvë dhe qëllimi i saj ishte që zgjerimi i diapazonit të njohurive të nxënësve.



## Vizita e shkollës “Shqiponja”

Njëri ndër qëllimet kryesore të shkollës sonë është kontributi i saj në përparimin e të gjitha shkollave të Kosovës. Dhe ky qëllim, çdo ditë e më tepër është duke u realizuar. Që nga themelimi, shkolla jonë gjithmonë kishte bashkëpunim edhe me shkollat tjera. Nxënës të një shkolle tjetër, që erdhën ta vizitojnë shkollën tonë, më 3.12.2009, janë nxënësit e shkollës “Shqiponja” në Mitrovicë. Vizita e tyre kishte kryesisht, qëllimin e formimit të një bashkëpunimi në mes dy shkollave. Vizitorë ishin 15 nxënës të kësaj shkolle, të cilët ishin anëtarë të komitetit apo të parlamentit të shkollës së tyre. Vizitorët, e prirë nga drejtori i shkollës së tyre u takuan me anëtarët e parlamentit dhe të komitetit të shkollës sonë. Përveç kësaj, ata panë laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, teknologjisë, si dhe mënyrat se si zhvillohej mësimi nëpër këto laboratore të pajisura. Të ndarë të kënaqur nga vizita e tyre, nxënësit e shkollës “Shqiponja” ftuan edhe nxënësit e shkollës sonë t’u bënin vizitë shkollës së tyre, që sapo ishte ndërtuar.



## Dita e balonave

Përveç aktiviteteve mësimore, ka klasa të cilat kanë ditët e tyre të veçanta gjatë muajve. Ata gjatë çdo muaji caktojnë një ditë të cilën e festojnë në mënyra të ndryshme. Dita e balonave ishte një ditë e organizuar nga nxënësit e klasës VI\1. Këtë ditë, nxënësit sollën me vete balona në shkollë dhe më pas, gjatë orës së takimit javor zhvilluan lojëra të ndryshme me balona. Të gjithë nxënësit u argëtuan pa masë dhe më pas shkuan në objektin e ciklit të ulët. Ndërkohë, mësuesit e klasave të para, të dyta dhe të treta nxorën nxënësit në oborr. Klasat e gjashta lëshuan balonat nga lart dhe për fëmijët ishte një kënaqësi dhe befasi e madhe.



## Katër nxënës në Danimarkë

*Things Talk – Gjërat flasin*

Mundësitë për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme janë të mëdha, mirëpo duhet edhe përkushtim dhe dëshirë. Pjesë e kësaj dëshire për punë dhe kontribut në ngritjen e cilësisë së procesit mësimor kësaj radhe ishte arsimtari i Edukatës Fizike Driton Mamaj, i cili përmes projektit Open Fun Futboll Schools, që organizohet edhe në Kosovë mundësoi shkuarjen e pesë nxënësve të klasave të pesta në Danimarkë. Vizita në këtë vend skandinav të zhvilluar kishte për qëllim pjesëmarrjen në projektin Things Talk, në të cilën morën pjesë më se 22 shtete. Nxënësit e shkollës sonë ishin për herë të parë pjesëmarrës në këtë projekt. Këta nxënës përfaqësuan jo vetëm shkollën tonë, por edhe shtetin e Kosovës. Arsimtari së bashku me nxënësit sollën gjithë përvojën e parë dhe të treguar në këtë projekt. Nxënësit, Adea Loxha, Arian Bashota, Endrita Kadriu dhe Nol Gashi.

prezantuan punën e tyre në mbështetje të një bote më të pastër dhe të bukur. Riciklimi i mbeturinave të hedhura dhe të mundshme për t'u përdorur përsëri ishte qëllimi kryesor i këtij projekti i cili përfundoi me shumë sukses.



## Vlerësimi i jashtëm i nxënësve

Përveç vlerësimit të vazhdueshëm të nxënësve nga ana e mësimitdhënësve gjatë gjithë gjysmëvjetorit, një pikë e fortë që shfaq synimet e mira të shkollës është edhe vlerësimi i jashtëm i nxënësve. Në javën e parafundit të këtij gjysmëvjetori u organizua vlerësimi i jashtëm i cili u realizua përmes testeve të hartuara nga mësimitdhënës ekspertë jashtë shkollës, të lëndëve përkatëse. Gjatë çdo dite u mbajtën nga dy teste për dy lëndë të caktuara, në secilën gjeneratë.

Kjo javë i mobilizoi dhe i nxiti nxënësit që të sprovohen fuqishëm në mbrojtjen e arritjeve të tyre, pasi që rezultatet e dala ndikojnë drejtpërdrejt në notën përfundimtare. Ky lloj vlerësimi është një matës i mirë, që shërben për të parë arritjet e nxënësve gjatë gjysmëvjetorit dhe krahasimin e vlerësimit me atë të mësimitdhënësve, i cili ka qëllim kryesor ngritjen e nivelit të vlerësimit dhe procesit mësimor.



## Takimi Regjional i mësimitdhënësve dhe nxënësve

Arsimtarja e gjuhës angleze në shkollën tonë, Edita Bekteshi, mori pjesë në një Takim Regjional, i cili u mbajt në Ukrainë. Ky takim zgjati 8 ditë. Qëllimet e këtij takimi ishin: të gjesh veten – të kuptosh vetveten dhe njerëzit përreth, të respektosh të drejtat dhe obligimet e njerëzve, shpenzimet dhe kursimet dhe mënyrën se si bëhet planifikimi i buxhetit (shoqëror apo financiar). Projekti në fjalë quhet Aflatoun. Ky projekt u zhvillua së pari në Indi e Afrikë, më pas në Amerikën Jugore dhe atë qendrore, por tashmë edhe në Evropë, kryesisht në vendet e dala nga periudha komuniste.

Programi u zhvillua në bazë të lëndës së Edukatës Qytetare dhe si klub i veçantë, i njohur si Aflatoun. Shumë shtete tjera janë pjesë e këtij projekti. Tashmë edhe Kosova është bërë pjesë e këtij projekti, i cili zbatohet si program përmes teknikave të ndryshme, të cilat garantojnë sukseset e nxënësve.



## Këndi i nxënësve të dalluar

Në këtë rubrikë të letrës informative do t'ju prezantojmë nxënësit e dalluar të shkollës sonë. Kësaj here përzgjedhëm më të vegjlit, tre nxënës të klasës së parë, nga një për çdo klasë dhe tre nxënës nga klasa e pestë. Në numrin tjetër do t'ju prezantojmë tre nxënës nga klasat e dyta dhe tre nga klasat e gjashta.

Për më shumë, ata vetë prezantojnë dëshirat dhe vizionin e tyre për të ardhmen.



### Rron Aliu – V/1

Rron Aliu është një nxënës i dalluar, të cilit i pëlqen shumë lënda e Matematikës. Ai ka zgjedhur të shkojë në klubin e "Fizikanëve të Rinj." Ai e çmon shumë mësuesen e tij. Hobi i tij është të luajë me kitarë dhe të skijojë. Ëndrra e tij është të bëhet shkencëtar dhe kitarist. Këto plane ai pret t'i realizojë duke mësuar me përkushtim.

### Vesa Hasani – V/2

Vesa Hasani është një nga nxënëset e dalluara të kësaj shkolle. Asaj i pëlqen të shoqërohet, i pëlqejnë mësimdhënësit, ambienti në të cilin qëndron gjatë tërë javës, rregullat e shkollës e shumë e shumë gjëra të tjera. Preferon lëndën e Matematikës dhe të Edukatës qytetare. Hobi i saj është të lexojë, njëkohësisht edhe të shkruajë. Ëndërron të jetë një vajzë e sjellshme dhe të kujdeset për kafshët dhe për ambientin. Të gjitha këto provon t'i arrijë me anë të punës dhe beson se do t'ia dalë.



### Dion Beqiri – V/3

Dion Beqiri është nxënës shembullor. Atij i pëlqen shumë mënyra se si zhvillohet procesi mësimor dhe nxënësit me të cilët shoqërohet e punon në grupe. Lënda e tij e preferuar është Matematika. I pëlqen të bëjë projekte të ndryshme. Ai beson se do t'i realizojë të gjitha ëndrrat e tij në jetë. "Me përkushtim mund të arrish majat!" është porosia e tij.

**Ardian Kadriu – I/1**

Ardian Kadriu, një nga nxënësit e dalluar, të cilit i pëlqen shumë mësimi, argëtimi me shokët e shoqet e shumë gjëra të tjera. Preferon lëndën e Matematikës. Si hobi ka pikturimin. Ai dëshiron të bëhet astronaut, në mënyrë që të bëjë zbulime të shumta për universin.


**Dora Agani – I/2**


Dora Agani është një nxënëse e dalluar, të cilës i pëlqen të mësojë, si dhe të argëtohet me shokët e shoqet e saj. Lënda që e pëlqen më së shumti është lënda e Gjuhës shqipe. I pëlqen shumë këndimi. Ëndrra e saj është të ndjekë profesionin e stomatologes dhe konstaton se këtë do ta arrijë duke mësuar.

**Dukagjin Balaj – I/3**

Dukagjin Balaj është nxënës i shkëlqyer. Ai pëlqen mënyrën sesi mësuesja e tij i zhvillon orët mësimore. Lënda e tij e preferuar është Matematika dhe hobi i tij është mbledhja e kartave të ndryshme. Ai dëshiron ta shohë Kosovën të pastër.


**Nxënësit garojnë me studentët**

Se gramatika e gjuhës sonë përbën interesim të veçantë për nxënësit tanë, e vërteton edhe dëshira e tyre për të qenë prezentë në një orë studimore në Universitetin e Prishtinës. Dhe, pikërisht gjatë këtij gjysmëvjetori, arsimtarja e gjuhës shqipe Violetë Pllana organizon një vizitë në Fakultetin e Edukimit. Më shumë sesa të shohin se si funksionon puna në fakultet, nxënësit kishin dëshirën më të madhe të jenë edhe ata pjesë aktive e orës mësimore. Dhe, ashtu ndodhi. Bashkë me studentët, ata morën pjesë në dy orë të ushtrimeve të morfologjisë, duke shfaqur kështu përgatitjet e tyre në këtë fushë të gjuhës. Sikur studentët, ashtu edhe profesori u dha nxënësve lëvdata të shumta për suksesin e treguar. "Gramatikanët e rinj" të shkollës sonë u kthyen me motive shumë të ngritura dhe jashtëzakonisht të gëzuar për mundësinë e tyre që të jenë të barabartë me studentët, të paktën për këto dy orë. Tashmë këta nxënës e kanë të qartë se çfarë do të bëhen kur të rriten gjuhëtarë të zottë.



## Nxënësit e shkollës sonë publikojnë analizat tekstuale

Nxënësit e shkollës "Mileniumi i Tretë" janë lexues dhe krijues të mirë. Në mesin e tyre ka nxënës të dalluar, që me analizat e tyre të ndryshme nga fusha e letërsisë, konkretisht analizës tekstuale, mbërrijnë madje edhe nivelin e shkrimit akademik. Kështu, nxënësja Zana Buçinca, analizat e saj kritike tashmë i ka publikuar nëpër faqet e gazetave dhe revistave më të njohura në Kosovë, duke dhënë një shembull të pjekurisë në fushë të shkrimit dhe analizës letrare.

Kështu, shkrimi i saj në fushë të analizës krahasuese me titullin "Tat Tanushi si Konti Drakulla", i publikuar në shtojcën për kulturë të gazetës "Koha Ditore", ka zgjuar debate, madje edhe në qarqet akademike, për faktin se autorja në fjalë ka hetuar lidhje të forta ndërmjet novelës së Mitrush Kutelit dhe novelës së bazuar në legjendën për Drakulën, i cili është edhe roman i Bram Stokerit.

Javën që shkoi, nxënësja në fjalë, ka zgjuar interesimin e lexuesve edhe me një punim, të këtij niveli, i titulluar "Harry Potter si Mbreti i unazave" i botuar në shtojcën për kulturë (për të rritur) të gazetës "Kosova sot". Një analizë e tillë krahasimtare është për t'u çmuar, për faktin se për herë të parë hapur flitet për ndikimin dhe mbindërtimin e romanit shumëvëllimësh "Harry Potter" të autores J. K. Rowling nga romani "The Lord of the Rings".

E pyetur se çfarë e kishte nxitur që ajo të merret me tema të tilla në mes tjerash theksoi: *"E para janë orët e gjuhës shqipe, të cilat na mundësojnë që të reflektojmë më ndryshe ndaj veprave letrare në përgjithësi, që të kemi përherë një mendim kritik ndaj tyre. E dyta, gjatë këtyre orëve ndalemi në mënyrë të veçantë në analizën e teksteve të ndryshme. E treta, a nuk u duket nxitëse, mikluese, madje tejet e bezdisëse kur lexoni një roman bestseller, në disa vëllime siç është "Harry Potter"(1,2,3,4,5,6,7), dhe, në momentin që ju keni një tjetër roman në dorë, ju duket sikur po e lexoni të njëjtin? Kjo është për t'u shkruar, pavarësisht se ku dhe si prezantohemi"* përfundon Zana.

Gjithashtu, nxënësja në fjalë, nga redaktorë të gazetave më të njohura në Shqipëri, i është premtuar që së shpejti do t'i prezantohen edhe punime të tjera, asaj dhe nxënësve të tjerë të kësaj shkolle, të cilët tashmë kultivojnë këtë nivel shkrimi. Njërën nga këto analiza interesante, po ju ofrojmë edhe në faqet e kësaj letre informative.

### "Harry Potter" si "Mbreti i unazave"

Vepra shumëvëllimshme "Harry Potter", nuk është asgjë tjetër, veçse një reflektim i zbehtë i veprës madhështore "The Lord of the Rings", për të mos thënë "një mbindërtim i egër"; një huazim i pamëshirshëm tematik dhe tekstual

### "Harry Potter" roman epik

Seria e librave "Harry Potter" ka thyer kufijtë e rekordeve të shitjes, duke hyrë në listën e librave më të lexuar të të gjitha kohërave, gjithsej i shitur në 44 milion kopje. Fillimisht, në qershor të vitit 1997 u botua libri i parë i kësaj serie "Harry Potter dhe Guri Filozofal", e pas tij edhe 6 librat pasues, deri tek libri i shtatë dhe i fundit "Harry Potter dhe Dhuratat e Vdekjes", i cili u botua në korrik të vitit 2007.



Rrëfimi për djaloshin jetim, Harry, është thurur në shtatë romane, të cilat e përbëjnë serinë e librave "Harry Potter". Për nga forma kompozicionale, "Harry Potter" është roman epik, i ndarë në kapituj. Narratori në këtë roman pozicionohet si narrator i gjithëdijshëm duke rrëfyer kryesisht për bëmat e Harryt. Protagonistët kryesorë të ngjarjes janë: Harry, Roni, Herimiona, Urtimori, e shumë të tjerë. Ndërsa, antagonistët janë po ashtu të shumtë duke filluar me Lordin Fluronvdekje, Hamortët, Drakon-in e të tjerë. Pitoni, që deri në librin e fundit mendohet të jetë antagonist në fund kuptohet se ishte njëri ndër protagonistët kryesorë që mundësuan shuarjen e Fluronvdekjes. Fshehtësi të tilla, të shumta që janë të pranishme në secilin prej librave të "Harry Potter"it, bëjnë të pamundur që libri të mos lexohet me një frymë, gjithashtu të shpërfaqet diskursi mistik. Dialogët në mes të personazheve janë të shumtë dhe përbëjnë pjesën më të madhe të romanit, i cili ka më shumë karakter rrëfyes sesa përshkrues. Vendi në të cilin zhvillohet e tërë kjo 'dramë' është Anglia. Ndërsa, koha është kryesisht objektive, por kur hyn në lojë Kohëkthyesi i Hermionës, atëherë ajo shndërrohet në kohë subjektive.

Gjithçka në këtë vepër ka të bëjë me fantastikën, gjë që e mundëson përdorimin e diskursit fantastik dhe atë mitik.

Alegoria, e përdorur më së shumti në fjalët e Urtimorit dhe figura të ndryshme stilistike sfidojnë lexuesin, të cilin e bëjnë të reflektojë rreth zgjidhjes së misterit, i cili në fund zgjidhet në mënyrë krejtësisht ndryshe nga hipotezat tona.

Mesazhet që mund të nxirren nga vepra janë të shumta dhe ndryshojnë nga secili vëllim, por mesazhi i cili përcillet që nga "Harry Potter" dhe Guri Filozofal deri tek "Harry Potter dhe Dhuratat e Vdekjes" është: Dashuria gjithmonë ngadhënjën mbi të keqen dhe urrejtjen.

Si fabul vepra bën fjalë mbi jetimin "Harry Potter". Harryt i kishin vdekur prindërit dhe ishte rritur nga xhaxhai dhe teza e tij. Në ditëlindjen e 11 Harry kupton se ishte magjistar. Kështu shkon në Hoguorts, shkollë e magjisë. Secili nga librat e serisë paraqet një vit të Harryt në Hoguorts. Por, në secilin libër para tij shfaqen sfida të reja për shkatërrimin e magjistarit më të fuqishëm dhe më të tmerrshëm të të gjitha kohërave, Lordit Fluronvdekje, qëllim të cilin e arrin në librin e fundit.



### **"The Lord of the Rings" burim i intertekstualitetit**

Por, a është e mundur që autorja e librave "Harry Potter", librave më të famshëm për fëmijë, J.K.Rowling të ketë "huazuar" elemente nga një tjetër libër bestseller?

Ngjashmëria në mes "Harry Potter" dhe "The Lord of the Rings" është tejet e hetueshme. "The Lord of the Rings" i J.R.R.Tolkien, i botuar në vitin 1954 është, po ashtu njëri ndër librat që ka arritur majat e lexueshmërisë, me 150 milion kopje të shitura. Me gjithë faktin se është shkruar gjysmë shekulli më parë, "The Lord of the Rings" vazhdon të jetë libri i cili kryeson në listën e librave imagjnativ të letërsisë për të rritur. Pafundësia e imagjinatës së autorit të këtij libri është burim i pashtershëm, nga i cili çdo autor i veprave të tilla shuan etjen e tij.

Sikur ta krahasojmë "Harry Potter"-in me "The Lord of the Rings" përfundojmë se J.K.Rowling jo vetëm se "ka shuar etjen", por më shumë se kaq në "burimin e imagjinatës" së autorit të madh J.R.R.Tolkien e ka shfrytëzuar skajshmërisht.

Për të parë këtë "intertekstualitet", le ta analizojmë pjesën fabulare të veprës "The Lord of the Rings".

Jeta e Frodo Baginsit, jetimit të rritur nga xhaxhai i tij Bilbo, merr kthesë pikërisht në ditëlindjen e tij të 33-të (e cila ishte ditëlindja e 111 e Bilbo-s gjithashtu). Atij i ngarkohet unaza, që i përkiste magjistarit më të ligë Sauronit. Frodo duhet ta shpjerë atë unazë të ligë deri tek vendi ku edhe është krijuar në Mordor, pasi që ai është vendi i vetëm ku mund të asgjësohet. Unaza e tërheq Frodo-n të bëhet i ligë dhe t'i vë në vend urdhrat e Sauronit. Libri tregon për shoqërinë e unazës, shoqëria me Frodon në krye që ka për detyrë ta shkatërrojë unazën dhe për pengesat që shfaqen gjatë rrugës së tyre për në Mordor. Frodoja, Semi, Gandalfi, Aragorni, Legolasi dhe shumë të tjerë janë protagonistët e kësaj ngjarjeje. Antagonistët, janë gjithashtu të shumtë, si: Sauroni, Kalorësit e zinj, Sarumani etj.

## **“Harry Potter” përballë “The Lord of the Rings”**

Libri “The Lord of the Rings” përmban elemente të shumta fantastike dhe imagjinate, të cilat e kanë nxitur, me ose pa dashje edhe vetë autoren e “Harry Potter”it të marrë aq shumë nga kjo kryevepër e mrekullueshme. Të krahasojmë së bashku në njëzet pika të përbashkëta, e që janë tejet të hetueshme nga secili lexues i vëmendshëm:

1. Personazhi kryesor; “Harry Potter” ishte jetim, pas vdekjes së prindërve ai ishte rritur nga xhaxhai dhe tezja e tij. Frodo Bagins, personazhi kryesor i “The Lord of the Rings,” gjithashtu ishte jetim dhe pas vdekjes së prindërve ishte rritur nga xhaxhai i tij, Bilbo Bagins.

2. E gjithë ngjarja fillon pikërisht në ditëlindjen e 11-të Harry-t dhe në ditëlindjen e 33 të Frodos. A u duket e rastësishme ditëlindja?!!

3. Si Harry-t, ashtu edhe Frodo-s iu ngarkohet një detyrë jo e lehtë për moshën që kanë. (Frodo, edhe pse 33 vjeç, njihet si i mitur në mesin e hobitëve që jetonin nga një shekull.) Edhe nga pamja fizike, këta dy personazhe kanë ngjashmëri.

4. Gjithashtu, gjatë aventurave, pranë tyre gjenden gjithmonë shokët e tyre besnikë. Roni, shoku i ngushtë i Harryt dhe Semit shërbëtori besnik i Frodo-s. Si Semi, ashtu edhe Roni, nuk lakmojnë në lavdinë e shokut të tyre, të cilët gjithmonë janë në qendër të vëmendjes.

5. Simboli i urtësisë dhe i së pamposhturës tek “Harry Potter” është Urtimori, një plak, me flokë dhe mjekër të bardhë, i cili i njeh fshehtësitë e botës. Ndërsa, tek “The Lord of the Rings” ky plak i gjithëdijshëm, flokë e mjekërbardhë është Gandalfi, i cili, po ashtu është një magjistar i dashur nga të gjithë.

6. Qëllimi i të dy protagonistëve kryesorë është që ta mposhtin magjistarin më të ligë të të gjitha kohërave. Tek Harry, Fluronvdekja, ndërsa tek “The Lord of the Rings”, Sauroni.

7. Të dy këta antagonistë janë të etur për pushtet, të etur për të mbizotëruar në botë.

8. Për t'u bërë i pavdekshëm Fluronvdekja e ka ndarë shpirtin e tij në shtatë horkurusë, të cilat janë gjëra të vlefshme. Njëri prej horkurusëve është pikërisht një unazë. Ai që i mban këta horkurusë afër, udhëhiqet nga e keqja. Këta horkurusë mund të shkatërrohen vetëm në mënyrë specifike. Po kështu, edhe Sauroni pushtetin e ka vendosur në një unazë, që po të asgjësohet do të shkatërrohet edhe ai.

9. Gjithashtu edhe kush e mban unazën udhëhiqet drejt së ligës. Shkatërrimi i unazës mund të bëhet vetëm në një mënyrë, mu ashtu siç bëhet edhe shkatërrimi i horkurusëve.

10. Siç është Manteli i padukshmërisë te Harry që të bën të padukshëm, ashtu edhe unaza tek “The Lord of the Rings” po të vihet në gisht të bën të padukshëm.

11. Kalorësit e zinj tek “The Lord of the Rings” janë shndërruar në Marrosës tek “Harry Potter”. Këto janë krijesa që mbajnë mantele të zeza me kapuçë dhe nuk shohin, por udhëhiqen nga shqisa e nuhatjes.

12. Shpata e Grifartit tek Harry, që paraqet shpatën e pamposhtur tek “The Lord of the Rings” është shpata e Isildurit.

13. Ashtu siç e ka rolin Shoqëria e Unazës për ta shkatërruar Sauronin, ashtu e ka rolin edhe Urdhri i Feniksit që ta shpëtojë botën nga Fluronvdekja.

14. Zogu, i cili shpëton Gandalfin shndërrohet në Feniks tek “Harry Potter” dhe shpëton Urtimorin gjithashtu.

15. Një krijesë tjetër që luan rolin e njëjtë si tek “The Lord of the Rings”- Gollum-i, ashtu edhe tek “Harry Potter” është Kriçeri. Këto janë krijesa të vogla, të liga e të pista që shumë herë arrijnë t'u shkaktojnë dëme protagonistëve.

16. Merimanga gjigante me të cilën luftojnë Frodo dhe Sem, tek Harry merr emrin Aragog dhe me të luftojnë, po ashtu edhe Harry me Ronin.

17. Katanatë gjigantë tek "Harry", janë njerëzit e stërmëdhenj (trolls) tek "The Lord of the Rings".
18. Edhe pse të mitur, si Harry ashtu edhe Frodo kanë ndikim të madh në mundjen e antagonistëve kryesorë të veprave.
19. Në natën e Hallouinit Harry, Roni dhe Hermiona luftojnë një përbindësh, mu ashtu siç e luftojnë një përbindësh të ngjashëm edhe Shoqëria e unazës.
20. Siç e reflekton pasqyra e dëshirave, tek "Harry" njeriun ashtu siç ka dëshirë të jetë, tek "The Lord of the Rings" këtë rol e ka uji, i cili e shfaq fundin e zemrës së njeriut.

Përfundimisht, pa hyrë në detaje si emra të shumtë të njëjtë të përdorur si tek "The Lord of the Rings", ashtu edhe tek "Harry Potter" huazimi i këtij të fundit mbi të parin është më se i qartë. Prandaj, "Harry Potter", nuk është asgjë tjetër, veçse reflektim (për fëmijë) i veprës madhështore "The Lord of the Rings," për të mos thënë "një mbindërtim i egër"; një huazim i pamëshirshëm tematik dhe tekstual.

**Zana Buçinca**

## Nxënësit gjatë aktiviteteve të ndryshme

